



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA DURRËS  
KËSHILLI BASHKIAK**

**VENDIM**

Nr. 1, datë 13.01.2023

**PËR**

**MIRATIMIN NË PARIM TË VLERËS FINANCIARE TË SHPRONËSIMIT PREJ 48342000 (DYZETËETETMILION E TREQINDEDYZETËEDYMIJË) LEKË, PËR PASURITË PRONË PRIVATE, SIPAS TABELËS SË HARTUAR NGA GRUPI I PUNËS, I NGARKUAR PËR KRYERJEN E VLERËSIMIT PARAPRAK, DHE ËSHTË PJESË E KËTIJ VENDIMI, QË PREKEN NGA INVESTIMI PUBLIK ME OBJEKT: “PROJEKT ZBATIMI PËR NDËRTIMIN E SHËTITORES SË PLAZHIT DURRËS, NGA URA E DAJLANIT DERI NË GODINËN E KOVALISHENCËS”**

Në mbështetje të nenit 41 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 9, pika 1.2/b të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, ligjit nr.8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik”, i ndryshuar, sipas relacionit të përgatitur nga Drejtoria Ligjore, me propozim të Kryetares së Bashkisë,

**KËSHILLI BASHKIAK  
VENDOSI:**

1. Miratimin në parim të vlerës financiare të shpronësimit prej 48342000 (dyzetë e tetmilion e treqindedyzetë e dymijë) lekë, për pasuritë pronë private, sipas tabelës së hartuar nga grupi i punës, i ngarkuar për kryerjen e vlerësimit paraparak, dhe është pjesë e këtij vendimit, që preken nga investimi publik me objekt: “Projekt zbatimi për ndërtimin e shëtitores së Plazhit Durrës, nga Ura e Dajlanit deri në godinën e kovalishencës”.

2. Fondi i shpronësimit me vlerë 48342000 (dyzetë e tetmilion e treqindedyzetë e dymijë) lekë të parashikohet në buxhetin e vitit 2023. Lëvrimi i fondit do të kryhet pasi të jetë botuar VKM-ja për shpronësim.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Drejtoria e Buxhetit dhe Drejtoria Ligjore.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit Nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar.

**KRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK**

**Ani Dyrmishi**




**U shpall sot me datë 13.01.2023**



PRONARI		TË DHËNA HIPOTEKORE											VLERSIMET PËR SHPRONËSIM SIPAS LLOJIT TË PASURISË			
Emër	Atësi	Mbiemër	Z.K	Nr. Pas	Lloji pas	Sip. Tot	Truall	Ndërtes	Volum	Faqe	Sip. (m <sup>2</sup> )	Çmimi (lekë/m <sup>2</sup> )	Vlera (lekë)	Shpronsim tokë "truall"		
Ymer		Hajdari	8518	5/58	Truall	433	433	111,8	2	148	760	20000	15200000			
Mëreme		Kila	8518	4/50	Truall	727	727	0	68	156	34,6	20000	692000			
Dilaver		Mezini	8518	4/49	Truall	73	73	0	68	157	12,2	20000	244000			
Dëshuri	Zija	Hoxha														
Dhurata	Hasan	Zela														
Gëzim		Hoxha														
Rahim	Hasan	Korbi	8518	8/110	Truall	500	500	0	13	98	138,2	20000	2764000			
Reshit	Hasan	Korbi														
Shpresa	Hasan	Raxhimi														
Zenel	Hasan	Korbi														
Behixhe	Hasan	Fortuzi														
Zaralanda	Skrat	Kopali	8518	10/32	Truall	120	0	0	26	89	77	20000	1540000			
Andrea	Sotir	Rexha														
Dafina	Izet	Rexha														
Kristaq	Sotir	Rexha														
Landi	Sotir	Rexha														
Lefka	Sotir	Cekani	8518	10/33	Truall	480	480	0	26	90	352,8	20000	7056000			
Loreta	Gole	Puleshi														
Mantola	Gole	Puleshi														
Mitrush	Sotir	Rexha														
Pulie	Sotir	Cikcu														
Rami	Muhamed	Ismaili	8518	27/111	Truall	400	400	0	17	247	316,8	20000	6336000			
Naim	Sadri	Kapiti	8518	27/112	Truall	400	400	94	17	248	195	20000	3900000			







REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
PREFEKTI I QARKUT DURRËS

Nr. 49/prot.

Durrës, më 24.01.2023

**Lënda:** Verifikim i ligjshmërisë së aktit

**KËSHILLIT BASHKIAK**  
**DURRËS**

**KRYETARIT TË BASHKISË**  
**DURRËS**

Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr.1 datë 13.01.2023 “Për miratimin në parim të vlerës financiare të shpronësimit prej 48342000 (dyzetëetmilion e treqindedyzetëedymijë) lekë, për pasuritë pronë private, sipas tabelës së hartuar nga grupi i punës, i ngarkuar për kryerjen e vlerësimit paraprak, dhe është pjesë e këtij vendimi, që preken nga investimi publik me objekt: “Projekt zbatimi për ndërtimin e shëtitores së Plazhit Durrës, nga Ura e Dajlanit deri në godinën e Kovalishencës”

E gjej atë të bazuar në ligj dhe në bazë të kompetencave që me jep Ligji Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, e konfirmoj bazueshmërinë ligjore të tij.  
Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

**PREFEKTI**

**EMILJAN JANI**

